



**MESAZHI PASKAL i Fort Lumturisë së Tij
Mitropolitit Tikon
Pashka 2020**

Për Klerin e Vyer, Monahët dhe Besimtarët e Kishës Ortodokse në Amerikë,

Krishti u Ngjall! Vërtet u Ngjall!

Sot festojmë Festën e festive; të gëzueshmen, rrezatuesen Festë të Ngjalljes së Zotit. Ai u bë një Njeri si ne dhe u kryqëzua, vuajti dhe u varros për ne. Dhe sot, pas tre ditësh në varr, Ai u ngrit nga të vdekurit, duke na ofruar të gjithë premtimin e Ngjalljes për jetën e përjetshme.

Jeta jonë në Ngjalljen fillon tani. Megjithëse ende jetojmë në trup, nuk duhet të jetojmë sipas mishit, duke menduar vetëm për nevojat dhe dëshirat tona trupore. Ngjallja e Jezu Krishtit na bën thirrje, pavarësisht situatës sonë në jetë, të jetojmë tani një jetë të pjekur shpirtërisht. Thelbi i një jete të tillë shpirtërore është që njëri të japë jetën për të tjerët, një imitim i Krishtit i cili vdiq për të mirën e të gjithëve. Kjo është thirrja e jetës së re që Ngjallja e Krishtit na jep: "kështu që sikundër Krishti u Ngjall prej së vdekurish me lavdinë e Atit, edhe ne gjithashtu të mund të ecim në risitë e jetës (Romakëve 6:4)."

Këtë vit, festimet tona të Pashkës vijnë në mes të pandemisë së Covid-19, dhe askush nga ne nuk po përjeton festimet e plota të shërbesave. Pak veta janë të pranishëm në shërbesat e kufizuara, ndërsa shumica po luten në shtëpië e tyre. Megjithatë, të gjithë ne, kudo që ta gjejmë veten, mund të jetojmë sipas Ngjalljes duke vënë nevojat e të tjerëve përpara tonave. Në Dhjatën e Vjetër, në të njëjtën frymë me të cilën Perëndia i nxiti njerëzit e Tij që "të ruajnë Sabatin e Tij", Ai gjithashtu u bëri thirrje atyre që të kujtojnë të varfërit dhe bujtësit, dhe t'u lënë atyre pjesë të grurit dhe rrushit të tyre (Levitiku 19:3-10). Edhe ne gjithashtu, duke e mbajtur Pashkën e Zotit, si Sabatin e Parë, të kujtojmë të varfërit dhe nevojtarët, të sëmurët dhe të vuajturit përpara vetes, veçanërisht në këtë kohë të trazirave ekonomike të shkaktuara nga Koronavirusi. Meqenëse shumë prej nesh nuk janë në gjendje të kungohen me Bukën qiellore të Trupit të Krishtit në këtë kohë siç është zakoni, të paktën le të përqëndrohemi që të sigurojmë vëllezërit dhe motrat tanë rreth nesh të kenë mjaft bukë të përbashkët: ushqim dhe nevoja të tjera themelore. Duke vepruar kështu, do të ndjekim shembullin e Krishtit, i cili bëri të sigurt që mijëra të kishin ushqim të mjaftueshëm dhe i cili punoi për të shëruar të lënguarit dhe të sëmurët.

Bijtë e mi të dashur në Krishtin, mënyra me të cilën festojmë Pashkën këtë vit, qoftë në shtëpitë tona ose në shërbesime të kufizuara, nuk duhet t'i sugjerojë askujt që Pashka e Zotit tonë është anuluar ose në ndonjë mënyrë është zvogëluar. Duke falënderuar Krishtin për misterin e Tij të Shpëtimit, le të thërrasim të gjithë me guxim dhe siguri të plotë, "Krishti u Ngjall!" Le të përgjigjemi, me të vërtetë, duke ecur me guxim në "jetën e re" që Krishti na jep sot.

Krishti u Ngjall! Vërtet u Ngjall!

+TIKONI

Kryepeshkop i Uashingtonit

Mitropolit i Gjithë Amerikës dhe Kanadasë